



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË RANILLUGUT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Ranillugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ranillugut (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ranillugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Ranillugut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Gjatë angazhimit tonë kemi gjetur se Komuna nuk ka vepruar në pajtueshmëri me autoritetet si:

- A1 Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 14 zyrtarë për shërbime të veçanta, për këto angazhime Komuna kishte zhvilluar procedurat të rekrutimit, mirëpo nuk kishte udhëhequr procedurë të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ranillugut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Ranillugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Ranillugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Ranillugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Ranillugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë të bëjnë me dobësitë në përgaditjen Pasqyrave Financiare, angazhimin e punonjesve jo përmes prokurimit, mos verifikimin e pronave sipas kërkesave ligjore, dobësi në menaxhimin e pasurive, të arkëtueshmeve dhe mos funksionimin e plotë të njësisë së auditimit të brendshme. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me shtatë rekomandime, prej tyre dy rekomandime të reja, katër të përsëritura dhe një pjesërisht i zbatuar.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Angazhimi i kontratave për shërbime të veçanta jo përmes prokurimit

Gjetja	<p>Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 thekson se - Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.</p> <p>Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 14 zyrtarë për shërbime të veçanta, për këto angazhime Komuna kishte zhvilluar procedurat të rekrutimit, mirëpo nuk kishte udhëhequr procedurë të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik.</p> <p>Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrollit jo të mirë, që këto shërbime të përzgjidheshin përmes procedurave të prokurimit.</p>
Ndikimi	<p>Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu e rrit edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyrat e caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancë e tyre në punë.</p>
Rekomandimi A1	<p>Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A2 - Dobësitë në përgatitjen Pasqyrave Financiare

Gjetja

Sipas Rregullores së MF-së Nr. 01/2017 për raportimin financiar vjetor të organizatës buxhetore, është përcaktuar mënyra e përgatitjes së PFV e cila është në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik për Raportimin Financiar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme.

Gjatë rishikimit të PVF kemi identifikuar dobësitë si në vijim:

- Tek shënimi 11, Grantet e përcaktuara të donatorëve janë prezantuar në vlerë 20,700€, ndërsa do duhej të ishin zero; dhe
- Tek shënimi 13, Pagesat nga palët e treta janë prezantuar në vlerë 9,999€, ndërsa do duhej të ishin zero.

Ndikimi

Paraqitja e pasaktë dhe jo e plotë e informatave financiare dhe jo financiare në PVF-të, ka ndikuar në pa saktësi të të dhënave dhe ulë shkallën e besueshmërisë së tyre.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të shtoj kontrollat gjatë hartimit të PVF-ve, në mënyrë që PVF-të për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të nënshkruaj vetëm pasi që janë siguruar se PVF-të prezantojnë të dhëna të plota dhe të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Ranillugut në 2021 ishin 89,182€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore.

Çështja B1 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

Gjetja	<p>Sipas nenit 15.2 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme parashihet që veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të gjitha objekteve brenda territorit të komunës.</p> <p>Komuna në vitin 2021, prej 1,297 pronave të regjistruara kishte arritur të kryej verifikimin e vetëm 40 objekteve apo 3% të pronave të paluajtshme</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak se në njësinë e tatimit në pronë është i punësuar vetëm një zyrtar, i cili për shkak të vëllimit të punëve, nuk kishte mundësi të përmbush këtë kërkesë ligjore.</p>
Ndikimi	<p>Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në ngarkesa tatimore joadekuate.</p>
Rekomandimi B1	<p>Kryetari duhet të marrë në konsideratë plotësimin e vendeve të punës në këtë departament, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer verifikimin e objekteve sipas dispozitave ligjore.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 8,563,866€, pasurive jokatitale është 102,299€, si dhe e stoqeve ishin zero. Kemi testuar 44 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 117,246€.

Çështja B2 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë neni 6, pika 3 pasuria nën 1,000€, duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Komuna nuk përdorë programin E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë nën 1,000€, për regjistrimin e pasurisë nën 1,000 komuna përdor aplikacionin Excel.

Zyrtarët komunal pohojnë se ka probleme teknike me funksionalizimin e këtij Softueri dhe se MAP/MBP nuk ka kontratë për mirëmbajtje të këtij sistemi.

Ndikimi Mos përdorimi i programit E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë pasqyrojnë dobësi në menaxhimin e pasurive dhe rrjedhimisht ndikon në mos prezantim të drejtë të vlerës së pasurisë në PFV.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë funksionalizimin e sistemit E-pasuria siç e kërkon rregullorja në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 493,518€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 254,676€, taksë për ushtrimin e veprimtarisë afariste 63,942€, shitja e shërbimeve 156,241€ dhe shfrytëzimi i hapësirave publike 18,659€.

Çështja B3 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenin 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna për të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 254,676€ të cilat krahasuar me vitin e kaluar ishin rritur për 45,062€, nuk kishte ndërmarr ndonjë aktivitet për mbledhjen e tyre siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë.

Sipas nenit 56 të rregullores për taksat tarifa dhe gjopa komunale, ndër të tjera si mekanizëm për mbledhje të borxhit parashihen edhe veprimet si: borxhliut i dërgohet urdhër për pagesë të taksës me vërejtjen për përmbarim, kamata do të fillojë të llogaritet nga data e vendosur në vendim për arkëtimin e borxhit; ndërprerja e veprimtarisë afariste (mbyllja për tri ditë); malli do të regjistrohet dhe do të merret (konfiskimi i pasurisë) dhe shitja e pasurisë përmes ankandit. Të arkëtueshmet nga shitja e shërbimeve (mbledhja e mbeturinave) në fundi të vitit 2021 ishin 156,241€, që i bie nga viti i kaluar janë rritur për 20,375€. Të arkëtueshmet nga shfrytëzimi i hapësirave publike ishin rritur për 3,177€ krahasuar me vitin 2020, si dhe të arkëtueshmet për taksat e ushtrimit të veprimtarive ishin rritur 9,879€ në raport me vitin e kaluar.

Komuna nuk kishte marrë ndonjë aktivitet për mbledhjen e këtyre llogarive të arkëtueshme siç parashihet me ligj apo rregullore, përveç daljes së inspektorëve në terren për mbledhjen e taksave për biznese dhe shfrytëzimin e pronës komunale.

Ndikimi Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuara me ligj ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, dhe inkurajon debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre. Rrjedhimisht, kjo redukton kapacitetin e komunës për të financuar nevojat e saj nga burimet vetjake.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të analizojë në mënyrë të detajuar gjendjen e borxheve që debitorët i detyrohen komunës, të propozoj masa më efektive si dhe të aplikoj të gjithë mekanizmat në dispozicion për mbledhjen e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm (NJAB).

Çështja C1 - Mos funksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Komunë

Gjetja Sipas rregullores QRK.nr01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 4, parasheh se Komuna ka katër mënyra për kryerjen e auditimeve të brendshme: themelimin e njesisë së auditimit në kuadër të Komunës, njësi të përbashkët me subjekte të tjera të sektorit publik, marrëveshje me ndonjë subjekt publik për kryerjen e shërbimeve të auditimit apo edhe kontraktimit të një kompanie profesionale

Komuna gjatë vitit 2021 nuk kishte kryer asnjë auditim të brendshëm, pasi që auditori i brendshëm ishte në pushim pa pagesë në fund të vitit dhe si rezultat Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ishte funksionale. Pas kthimit në punë nga pushimi, kishte hartuar vetëm planin Strategjik dhe Vjetor të auditimit, mirëpo nuk kishte arritur të kryej asnjë raport të auditimit.

Ndikimi Mos funksionimi përgjatë vitit i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nënkupton që Komuna nuk kishte sigurur një mekanizëm të pavarur dhe objektiv i cili shërben si këshillëdhënës në ofrimin e sigurisë së arsyeshme mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve operative.

Rekomandimi C1 Kryetari i Komunës të sigurojë që Njësina e Auditimit të Brendshëm, të fillojë me kryerjen e auditimeve sipas planit të saj

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mungesa e komitetit të auditimit

Gjetja Udhëzimi administrativ MF-nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 4.1 themelimi i komitetit të auditimit: Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësine e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjisllacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Komuna ende nuk kishte themeluar Komitetin e Auditimit, edhe pse lidhur me këtë ishte dhënë rekomandim edhe vitin e kaluar. Për këtë ishte propozuar që të themelohej në fund të vitit 2021.

Ndikimi Mungesa e komitetit të auditimit mund të ndikojë në pavarësinë e Njesisë së Auditimit nga ndërhyrjet e menaxherëve, si dhe mos-adresimin e duhur të rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të themelojë dhe ta bëjë funksional komitetin e auditimit, që t'i rishikojë rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,552,183	1,775,517	1,588,396	1,961,837	1,682,939
Grante Qeveritare - Buxheti	1,430,358	1,429,951	1,388,493	1,879,797	1,629,933
Financimi përmes huamarrjes	0	5,444	5,444	16,380	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	215,874	157,777	55,083	44,227
Të hyrat vetanake	121,825	121,825	36,681	10,576	8,779
Donacionet e jashtme	0	2,423	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 223,334€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga vitit i kaluar, financimi nga huamarrja dhe donacioneve

Në vitin 2021, Komuna ka shpenzuar 89% të buxhetit përfundimtar në 2021 ose 1,588,563€, me një përmirësim 7% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,552,183	1,775,517	1,588,396	1,961,837	1,682,939
Pagat dhe mëditjet	1,120,000	1,125,037	1,124,869	1,111,363	1,086,777
Mallrat dhe shërbimet	215,000	257,235	213,606	217,205	167,009
Komunalitë	45,000	65,000	37,151	39,581	35,142
Subvencionet dhe transferet	40,000	60,000	37,343	295,394	34,938
Investimet Kapitale	132,183	268,245	175,426	298,294	359,073

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,037€. Fillimisht me rishikim të buxhetit ishte rritur për 40,235€ ndërsa me vendime ishte zvogëluar për 35,198€. Shpenzimet ishin 100% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 42,235€. Kjo rritje ishte prej të hyrave vetanake të bartura 40,000€ dhe donacioneve për 2,235€. Shpenzimet ishin 83% e buxhetit;
- Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 20,000€, e të cilat ishin prej të hyrave vetanake të bartura. Shpenzimet ishin 57% e buxhetit;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 20,000€ e të cilat ishin prej të hyrave vetanake të bartura. Shpenzimet ishin 62% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 136,062€. Kjo rritje ishte prej të hyrave vetanake të bartura 135,874€ dhe donacioneve për 188€. Shpenzimet ishin 65% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga 2021 ishin në vlerë 89,182. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksat për ushtrim të veprimtarisë, të hyrat nga shitja e shërbimeve dhe shfrytëzimi i hapësirave publike etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	121,825	121,825	89,487	60,131	88,904
Të hyrat tatimore	42,306	42,306	31,642	27,837	26,085
Të hyrat jo tatimore	79,519	79,519	57,845	32,294	62,819

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Ranillugut ka rezultuar në 7 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, një (1) është zbatuar, një (1) është pjesërisht, katër (4) nuk ka filluar zbatimin dhe një (1) nuk është i aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikonin 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se paraqitja e pagesave nga palët e treta të bëhet sipas kërkesave të rregullores për raportim financiar.	Nuk ka raste të tilla.	I zbatuar
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të marrë në konsideratë plotësimin e vendeve të punës në këtë departament, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer verifikimin e objekteve sipas dispozitave ligjore.	Ende nuk ka arritur të bëjë verifikimin sipas dispozitave ligjore.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se plani vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, do të përgatitet dhe dërgohet me kohë në ZKM, duke përcaktuar qartë fondet e parapara për subvencione dhe fushat të cilat do të mbështeten nga komuna.	Nga buxheti i vitit 2021 nuk ka pasur financim të OJQ-ve.	Nuk është i aplikueshëm më
4.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se në raportin e inventarizimi të pasurisë të përfshihet e gjithë pasuria e cila është pronë e Komunës. Gjithashtu duhet të sigurojë funksionalizimin e sistemit E-pasuria siç e kërkojnë rregulloret në fuqi si dhe të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth pasurisë.	Edhe këtë vit Komuna ka raportuar pasuritë nën 1000 euro nga regjistri i Excel-it.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të analizojë në mënyrë të detajuar gjendjen e borxheve që debitorët i detyrohen komunës, të propozoj masa më efektive si dhe të aplikoj të gjithë mekanizmat në dispozicion për mbledhjen e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat ligjore.	Edhe në këtë vit kemi rritje të llogarive të arkëtueshme për 45,062 euro në raport me vitin e kaluar. Nuk ka veprime për mbledhjen e tyre siç përcaktohet me ligj.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të themelojë dhe ta bëjë funksional komitetin e auditimit, që t'i rishikojë rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.	Ende nuk është themeluar Komiteti i Auditimit.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari i Komunës të funksionalizojë Njësinë e Auditimit të Brendshëm, ose të shqyrtohen mundësitë tjera të sigurimit të shërbimeve të auditimit, siç përcaktohen me Rregulloren e mësipërme.	Drejtori i NJAB-së është kthyer nga pushimi, ndërsa përveç Planit strategjik dhe vjetor për vitin 2021 nuk kishte kryer asnjë auditim.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme







Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)



Shtojca I: Letër konfirmimi

 <p>Republika Kosovo Republika e Kosovës Republic of Kosovo</p>	<p>Opština Ranilug Komuna e Ranillugut Municipality of Ranilug</p> 	
<h3>LETËR E KONFIRMIMIT</h3>		
<p>Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p>		
<p>Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit</p>		
<p>Të nderuar,</p>		
<p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p>		
<ul style="list-style-type: none">• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Ranillugut, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");• pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.		
		
<p>Znj. Katarina Ristić Ilić</p>		
<p>Kryetare e Komunës së Ranillugut,</p>		
<p>Data: 01.qershor.2022, Ranillug.</p>		

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.